Clean Fast sh.p.k

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020

Tiranë, Shqipëri

CLEAN FAST Sh.p.k.
NUIS: L67907013R
TIRANË - ALBANIA

PERMBAJTJA:

	PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)	2
	PASQYRA E PERFORMANCES	3
	PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	5
	PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	6
1.	**Informacion i pergjithshem**	7
2.	**Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile**	7
2.	**Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile (VAZHDIM)**	9
2.	**Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile (VAZHDIM)**	10
3.	**Mjete monetare**	12
4.	**Te drejta te arketueshme**	12
5.	**Inventaret**	12
6.	**Aktivet materiale dhe jo materiale**	13
7.	**Parapagime per aktive materiale**	14
8.	**Furnitore dhe detyrime te tjera**	14
9.	**Dividend i pagueshem**	14
10.	**KAPITALET E VETA**	14
11.	**Te ardhurat nga shitja e mallrave**	14
12.	**Rakordimi i te ardhurave**	15
13.	**Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme**	15
14.	**Shpenzime per personelin**	15
15.	**shpenzime te pergjithshme dhe administrative**	15
16.	**Shpenzime te tjera**	16
17.	**Shpenzime financiare**	16
18.	**fitimi neto**	16
19.	**aktivet e kushtezuara**	17
20.	**Ngjarje te tjera pas dates bilancit**	17

CLEAN FAST Sh.p.k. NUIS: L61810703TR TIRANË - ALBANIA

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)
(Gjithë vlerat në Lekë)

	Shënime	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
AKTIVI			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	3	21,138,610	17,615,155
Të drejta të arkëtueshme		-	
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	4	10,746,827	14,530,809
Të tjera	4	4,899,287	4,607,342
Inventarët	5	178,000	147,000
Shpenzime të shtyra	4	78,018	68,827
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	4	1,107,159	487,901
Totali i aktiveve afatshkurtra		**38,147,902**	**37,457,034**
Aktivet afatgjata			
Aktive materiale	6	6,895,728	5,341,273
Parapagime për aktive materiale	7	222,116	222,116
Aktivet jo materiale	6	62,250	83,076
Totali i aktiveve afatgjata		**7,180,094**	**5,646,465**
TOTALI I AKTIVEVE		**45,327,996**	**43,103,499**
KAPITALI DHE DETYRIMET			
Të pagueshme për aktivitetet e shfrytëzimit	8	2,276,578	1,366,689
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore / shëndetësore	8	1,551,898	3,317,593
Të pagueshme për detyrime tatimore	8	937,570	708,456
Dividend i pagueshem	9	16,017,674	14,401,607
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**20,783,719**	**19,794,345**
Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë		-	-
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Total i detyrimeve		**20,783,719**	**19,794,345**
Kapitali i nënshkruar	10	100,000	100,000
Rezerva te tjera	10	1,597,114	1,597,114
Fitime/(humbja) e pashpërndarë	10	12,029,358	9,582,682
Fitim / (humbja)e periudhës	10	10,817,805	12,029,358
Kapitalet e veta		**24,544,277**	**23,309,154**
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		**45,327,996**	**43,103,499**

Pasqyrat financiare dhe shënimet shpjeguese nga faqja 1 deri 15 janë firmosur dhe miratuar me 31 Mars 2021 nga:

ADMINISTRATOR
Eriola Likaj

Shef Finance
Juna Cano

PASQYRA E PERFORMANCES
(Gjithë vlerat në Lekë)

	Shënim e	Për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	11	83,622,873	63,736,012
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	11	-	2,774,720
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	13	(17,454,271)	(12,507,440)
Shpenzime të personelit	14	(43,903,467)	(33,984,606)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	15	(4,994,529)	(2,567,526)
Shpenzime të tjera	16	(3,005,882)	(1,977,469)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6	(1,562,149)	(1,144,515)
Shpenzime financiare	17	145,226	(144,510)
Fitimi/ Humbja para tatimit		**12,847,801**	**14,184,666**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	18	(2,029,996)	(2,155,308)
Fitim/Humbja e vitit		**10,817,805**	**12,029,358**

CLEAN FAST Sh.p.k. NUIS: L61807301R TIRANË - ALBANIA

PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE
(Gjithë vlerat në Lekë)

	Shënim e	Për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2019
Fitimi/ Humbja e vitit		10,817,805	12,029,358
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërshirëse për vitin		10,817,805	12,029,358

CLEAN FAST Sh.p.k. NUIS: L67607037R TIRANË - ALBANIA

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

(Gjithë vlerat në Lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/ përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit			
Fitim/ Humbja e vitit		10,817,805	12,029,358
RregulIimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzime Zhvlerësimi dhe Amortizimi	6	1,562,149	1,144,515
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit			
Rënie/ (rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		2,809,332	(5,834,941)
Rënie/ (rritje) në inventarë		(31,000)	(17,201)
Rritje/ (rënie) në detyrimet e pagueshme		1,139,003	(2,521,385)
Rritje/ (rënie) në detyrime për punonjësit		(1,765,696)	1,052,353
Mjete monetare neto nga/ përdorur në aktivitetin e shfrytëzimit		**14,531,594**	**5,852,700**
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit			
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(3,095,778)	(1,226,347)
Mjete monetare neto nga/ përdorur në aktivitetin e investimit		**(3,095,778)**	**(1,226,347)**
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e financimit			
Arketime nga emetimi i kapitalit aksionar			
Hua të arkëtuara		54,255	10,097,210
Pagesa e huave			(10,151,465)
Interes i paguar			
Dividendë të paguar		(7,966,615)	(1,252,313)
Mjete monetare neto nga/ përdorur në aktivitetin e financimit		**(7,912,360)**	**(1,306,568)**
Rritje/ (rënie) në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		3,523,456	3,319,785
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në 1 Janar		17,615,155	14,295,370
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në 31 Dhjetor		**21,138,611**	**17,615,155**

CLEAN FAST Sh.p.k. NUIS: L67602301K TIRANË - ALBANIA

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO

(Gjithë vlerat në Lekë)

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva te tjera	Fitim/ Humbja e pashpërndarë	Fitim / Humbja e periudhës	Totali
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2018	**100,000**	-		**10,862,579**	**15,971,136**	**26,933,715**
Efekti i ndryshimeve në politikat kontabël	-	-		-		
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2019	**100,000**	-		**10,862,579**	**15,971,136**	**26,933,715**
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitim / (humbja) e vitit 2019	-	-			12,029,358	**12,029,358**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse					-	
Totali i të ardhurave gjithëpëfshirëse për vitin					12,059,358	12,029,358
Rezerva te tjera			1,597,114			1,597,114
Transaksione me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Emetimi i kapitalit të nënshkruar		-		-	-	
Dividendë	-	-		(15,6533,920)	-	**(15,653,920)**
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike		-		-	-	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 Dhjetor 2019	**100,000**	-	**1,597,114**	**9,582,681**	**12,029,358**	**23,309,153**
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 Janar 2020	**100,000**	-	**1,597,114**	**9,582,681**	**12,029,358**	**23,309,153**
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:						
Fitim / (humbja) e vitit 2020	-			-	10,817,805	**10,817,805**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-				- -	
Totali i të ardhurave gjithëpëfshirëse për vitin					10,817,805	**10,817,805**
Transaksione me pronarët e njësisë ekonomike të njohura direkt në kapital:						
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	-			-		
Dividendë	-			(9,582,681)		**(9,582,681)**
Totali i transaksioneve me pronarët e njësisë ekonomike				-		-
Pozicioni financiar më 31 Dhjetor 2020	**100,000**		**1,597,114**	**12,029,358**	**10,817,805**	**24,544,276**

CLEAN FAST sh.p.k NUIS: L07507001 TIRANE - ALBANIA

1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqëria "Clean Fast" sh.p.k është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në dt.06.06.2016. Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga një kuotë në vlerën 100.000 lekë, i paguar plotësisht dhe ortak i vetëm i shoqërisë me pjesëmarrje 100% është Zj.Eriola Likaj, e cila është dhe Administratore e shoqërisë. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në ambientet e marra me qira.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008, nga statuti i saj dhe legjislacioni në fuqi.

Objekti kryesor i veprimtarisë së shoqërisë përfshin sa më poshtë:

Shoqëria "Clean Fast" sh.p.k ka si objekt :- Aktivitet në fushën e lavanteri dhe pastrime, pastrime të ambjenteve të përbashketa , pastrime kimike për entet publike dhe private vendase dhe të huaja, banka, qëndra tregtare, spitale , shkolla , konvikte , hotele, restorante, kinema, etj. Veprimtari në fushën e pastrimit, desinfektimit, deratizimit, të ambjenteve të brendshme dhe të jashtme në entet publike dhe private . Pastrime, larje, sterilizime, disinfektime, hekurosje, paketime , dhe administrime të këtyre veprimtarive për persona fizik e juridik, ente publike etj. Aktivitete të lidhura me shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimeve. Shitje me shumicë e pakicë e mallrave të ndryshme, të pastrimit, ushqimore , industrial, të ndërtimit , mjeteve e pajisje teknologjike, sistemeve dhe pajisjeve elektroteknike e elektronike. Administrimi i qëndrave të reabilitimit, shtëpive të të moshuarve, qëndrave social kulturore e sportive.

Më 31 Dhjetor 2020 shoqëria kishte 155 të punësuar dhe gjatë vitit ka patur mesatarisht 124 të punësuar (31 Dhjetor 2019 shoqëria kishte 98 të punësuar dhe gjatë vitit ka patur mesatarisht 94 të punësuar). Adresa e subjektit: "Bulevardi Bajram Curri, Godina ETC, kati 13, Tiranë.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për ushtrimin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 janë miratuar nga Administratiori i shoqërisë Zj. Eriola Likaj më 21 Mars 2021.

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

a. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Paqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara (SKK) hyrë në fuqi nga 1 Janar 2015, të cilat përbëhen nga rregullat dhe interpretimet në përputhje me Ligjin nr.25/2018 datë 10/05/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Çdo veprim është mbështetur në dokumente justifikuese. Veprimet janë ngurtësuar me 31 dhjetor 2020.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë prezantuar në Lekë Shqiptare (LEKE), që është monedha funksionale e shoqërisë. Veprimet janë hedhur në mënyrë kronologjike dhe të kompjuterizuar në programin "FINANCA 5". Veprimet janë ngurtësuar më 31.12.2020.

b. Rëndësia dhe materialiteti

Pasqyrat financiare paraqesin të gjithë informacionin material që ndikon në pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare të njësisë ekonomike. Informacioni në këto pasqyra konsiderohet material, nëse mungesa ose pasaktësia në paraqitjen e tij do të ndikonte në

vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare. Zërat jomateriale mund të njihen duke përdorur metoda më të thjeshtuara.
Në mbeshtetje të SKK-ve të përmirësuara (SKK1 paragrafi 71) në përgatitjen e pasqyrave financiare rëndësi u jepet atyre aspekteve dhe të dhënave financiare të aktiviteteve ekonomike që janë të rëndësishme për përdoruesit e pasqyrave financiare dhe që mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që ata marrin. Rëndimi i pasqyrave financiare me hollësira të tepruara dhe informacion jomaterial dëmton qartësinë dhe kuptueshmërinë e tyre.

Në përcaktimin e materialitetit janë marrë parasysh aspektet cilësore dhe sasiore të informacionit.
Për kontabilizimin dhe raportimin e zërave jomaterialë në pasqyrat financiare kompania ka adoptuar plotësisht kërkesat e SKK-ve të përmirësuara edhe në përputhje me kërkesat SKK1 paragrafi 74 .
Informacioni, në lidhje me zërat dhe transaksionet materiale, do të shpjegohet më vete në shënimet e pasqyrave financiare. Zërat jomaterialë raportohen në pasqyrat financiare të grupuara me zëra të tjerë jomaterialë të ngjashëm.

c. Aktivet materiale dhe jomateriale

(i)*Njohja dhe matja*
Të gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii)Kostot e mëpasshme
Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

b. Aktivet materiale dhe jomateriale

(iii) Amortizimi
Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Toka nuk amortizohet.
Aktivet afatgjata jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që përfitime ekonomike do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme.

Normat e përdorura të amortizimit janë sipas ligjit 8438 dt.28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" për të gjitha aktivet që disponon shoqëria me përqindjet respektive tëmetodës së vlerës së mbetur ose lineare.

CLEAN FAST Sh.p.k. NUIS: L61808017R TIRANË - ALBANIA

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (VAZHDIM)

c. Inventarët

Vlerësimi në hyrje i inventarëve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjatë shitjes së mallrave shkarkimi bëhet me kosto mesatare. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve të fundit të ushtrimit që nga drejtimi është çmuar si vlera neto të realizueshme.

d. Llogaritë e arkëtueshme dhe llogari të pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe me pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

e. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat në Lekë dhe në monedha të huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

f. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit.

Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lekë):

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
1 EUR	123.7	121.77

CLEAN FAST Sh.p.k. NUIS: L67107017 TIRANË - ALBANIA

2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (VAZHDIM)

f. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara, mbështetur në dokumentacionin justifikues.Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftushme në marrjen e përfitimeve. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve, dhe në të njëjtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura, duke u mbështetur në dokumentacionin justifikues.

g. Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshëm për vitin aktual, bazohet mbi fitimin e tatueshëm, i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2017 është 15 % .

f. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet për pensione si edhe kontribute për sigurim shëndetësor për punonjësit e saj siç është parashikuar nga legjislacioni social vendas. Kontributet, bazuar në pagat, janë paguar në llogari të organizmave kombëtarë përgjegjës për pagesën e pensioneve dhe shpenzimeve shëndetësore. Nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me fondin për pensione dhe shpenzime shëndetësore.

g. Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të Shoqërisë dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar.

f. Grandet

Grandet e marra si të ardhura duhet të paraqiten në kredi të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, ose më vete, ose nën kategorinë e përgjithshme "Të ardhura të tjera", në vartësi të materialitetit. Të ardhurat nga grandi njihen gjatë periudhave kontabël, në mënyrë të tillë që të bëhet e mundur përputhshmëria e granditme shpenzimet që ai synon të kompensojë. Mjetet e marra ose të blera nëpërmjet grandeve njihen në bilanc, në të njëjtën mënyrë siç njihen mjetet e tjera të të njëjtit lloj. Për grandet që lidhen me shpenzimet e shfrytëzimit, ajo pjesë e grandeve që nuk është njohur akoma si e ardhur do të paraqitet në një zë më vete në pasiv të bilancit.

f. Provizionet, detyrimet dhe akivet e kushtëzuara

Njësia ekonomike do ta njohë një provizion vetëm kur një ngjarje detyruese ka ndodhur para datës së raportimit. Që një ngjarje të quhet detyruese, është e nevojshme që ajo të krijojë një detyrim ligjor ose konstruktiv për njësinë ekonomike, dhe që njësia ekonomike nuk ka asnjë alternativë tjetër për shmangien e këtij detyrimi, përveç shlyerjes së tij.Njësia ekonomike do të njohë një provizion në pasqyrat financiare të saj, në lidhje me të gjitha çështjet gjyqësore ekzistuese dhe ato të mundshme, në rastet kur:

a. një ngjarje detyruese, që ka krijuar çështjen gjyqësore, ka ndodhur para datës së raportimit;

CLEAN FAST Sh.p.k. NUIS: L61809037R TIRANË - ALBANIA

b. është e mundshme që njësia ekonomike të përballojë shpenzime, në lidhje me zgjidhjen e çështjes gjyqësore;
c. shuma e shpenzimeve të pritshme, që lidhen me çështjen gjyqësore, mund të vlerësohet relativisht me saktësi.
Nëse nuk plotësohen kushtet e lartpërmendura, provizioni nuk do të njihet në datën e raportimit, por çështjet që lidhen me gjyqin do të përshkruhen si një detyrim i kushtëzuar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.
Një aktiv i kushtëzuar është një kërkesë e mundshme që lind nga ngjarje të shkuara dhe ekzistenca e të cilit do të konfirmohet vetëm nëse ndodh ose nuk ndodh një ose disa ngjarje të ardhshme të pasigurta, të cilat nuk janë nën kontrollin e plotë të njësisë ekonomike.
Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, vecanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matat me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodh që vlerësimi mund të mos jetë në të linjë me rezultatin e cështjes. Drejtimi vlerëson në fund të cdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve, detyrimeve dhe aktiveve të kushtëzuara.

g. Korrigjimi i gabimeve

Në përputhje me kërkesat e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit kompania ka adoptuar plotësisht kërkesat e këtyre standardeve për vlerësimet kontabël dhe ndryshimet e tyre dhe korrigjimet e gabimeve.

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit specifikojnë se gabimet janë mosraportime ose deklarime të gabuara në pasqyrat financiare të një ose më shumë periudhave kontabël, të cilat vijnë nga mospërdorimi ose keqpërdorimi i informacionit të disponueshëm nga drejtuesit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Gabime të tilla përfshijnë efektet e gabimeve matematikore, gabimeve në zbatimin e politikave kontabël, paqartësitë apo keqinterpretimet e fakteve.

Gabimet ndryshojnë nga ndryshimet në vlerësimet kontabël. Ndryshimet në vlerësimet kontabël bazohen në informacion të mjaftueshëm dhe të besueshëm, si dhe në ndryshimin e tij me kalimin e kohës, dhe nuk kanë të bëjë me përdorimin e gabuar te tij. Gabimi karakterizohet nga fakti që, ndonëse drejtuesit e njësisë ekonomike kishin informacion të mjaftueshëm e të besueshëm për të përgatitur pasqyra financiare të sakta në kohën e përgatitjes së tyre, ky informacion nuk u përdor me saktësi.

h. Biznesi në vijimësi

Të dhënat e kontabilitetit janë mbajtur duke qënë në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit, në mënyrë të veçantë me bazën e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhës, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit në vijimësi.

Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të vijimësisë, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznesit.

CLEAN FAST sh.p.k. NUIS: L67802017R TIRANË - ALBANIA

3. MJETE MONETARE

Mjetet monetare për vitin që u mbyll me 31 Dhjetor 2020 janë të ndara sipas gjëndjes së tyre në arkë dhe në bankë. Shoqëria operon me 4 Banka, përkatësisht Bankën Kombëtare Tregëtare, Tirana Bank, Raiffeisen Bank dhe Union Bank. Tepricat e paraqitura më poshtë janë përkthyer me kursin e fundit të vitit të publikuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Arka	1,661,805	662,561
Banka	19,476,805	16,952,594
	21,138,610	**17,615,155**

4. TE DREJTA TE ARKETUESHME

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Klient dhe kërkesa të tjera të arkëtueshme	10,746,827	14,530,809
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara	1,107,159	487,901
Të drejta për tatim fitimin	703,295	357,548
Shpenzime të shtyra	78,018	68,827
Të tjera	4,195,992	4,249,794
	16,831,291	**19,694,879**

5. INVENTARET

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Materiale të para	178,000	147,000
Të tjera		-
	178,000	**147,000**

CLEAN FAST Sh.p.k. NUIS: L67504017S TIRANE - ALBANIA

6. AKTIVET MATERIALE DHE JO MATERIALE

	Makineri e pajisje	Paisje Zyre & Informatike	Mjete transporti	Software	Totali
Aktive të Trupëzuara					
Gjendje 01.01.2020	5,610,720	1,071,098	1,429,935	138,791	8,250,544
Shtesa	1,246,814	63,427	2,380,470	-	3,690,710
Pakësime	-	-	(594,934)	-	-
Gjendje 31.12.2020	**6,937,949**	**1,134,524**	**2,892,844**	**138,791**	**11,104,099**
Amortizimi					
Gjendje në 01.01.2020	1,668,169	154,379	725,814	55,715	2,604,078
Shtesa llogaritur	862,584	195,428	483,311	20,826	1,562,149
Pakësime	-	-	-	-	-
Gjendje në 31.12.2020	**2,530,753**	**349,807**	**1,209,125**	**76,541**	**4,166,226**
Vlera neto 01.01.2020	3,942,551	916,719	704,121	83,076	5,646,466
Vlera neto 31.12.2020	**4,326,781**	**784,717**	**2,006,346**	**62,250**	**7,180,094**

7. PARAPAGIME PER AKTIVE MATERIALE

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Parapagime për aktive materiale	222,116	222.116
	222,116	**222,116**

8. FURNITORE DHE DETYRIME TE TJERA

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Furnitorë	2,276,578	1,366,689
Të pagueshme ndaj punonjësve & sig. shoq./ shënd.	1,551,898	3,317,593
TAP	78,427	59,333
Detyrime për tatimin në burim	39,744	4,528
TVSH	813,922	644,595
Tatim fitimi	-	-
Detyrime të tjera	5,477	-
	4,766,046	**5,392,738**

9. DIVIDEND I PAGUESHEM

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Dividend i pagueshëm	16,017,674	14,401,607
	16,017,674	**14,401,607**

10. KAPITALET E VETA

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Kapitali	100,000	100,000
Rezerva Ligjore	-	-
Rezerva të tjera	1,597,114	1,597,114
Fitime të pa shpërndara	12,029,358	9,582,682
Fitim/humbja e vitit	10,817,805	12,029,358
Totali	**24,544,277**	**23,309,154**

11. TE ARDHURAT NGA SHITJA E MALLRAVE

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 83,622,873 Lekë (2019: 63,736,012 Lekë). Të ardhurat e tjera janë të grante të financuara nga Shërbimi Kombëtar i punësimit në bazë të programit të nxitjes së punësimit. Këto të ardhura janë ne 2019 2,774,720 Lekë.

12. RAKORDIMI I TE ARDHURAVE

2020	Sipas deklaratave tatimore	Korrigjimi	Sipas pasqyrave
Totali I te ardhurave	83,436,873	186,000	83,622,873
Korrigjimi I te ardhurave:			
Te ardhura te faturuara ne 2020 qe I takojne vitit 2019		(487,901)	
Te ardhura te faturuara ne 2021 qe i takojne vitit 2020		1,107,159	
Autongarkese TVSH-je		(67,141)	
Te ardhura nga shitja e aktiveve (pasqyruar fitim/humbja ne vleren neto ne shpenzime te tjera, sipas SKK-ve)		(366,120)	
Rrumbullakosje		3	
Totali i korrigjimit		186,000	
Totali I te ardhurave sipas pasqyrave financiare			83,622,873

13. LENDA E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Mallra e materiale të tjera	17,454,271	12,494,495
Mallra etj(të panjohura)		
Totali	**17,454,271**	**12,494,495**

14. SHPENZIME PER PERSONELIN

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Pagat dhe shpërblimet e personelit	37,238,255	29,053,436
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	6,665,212	4,882,903
Shpenzime të tjera për personelin		48,267
	43,903,467	**33,984,606**

15. SHPENZIME TE PERGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Viti i mbyllur __ Viti i mbyllur

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Shpenzime mirëmbajtje	765,763	914,619
Shpenzime sigurimi	525,835	135,775
Shpenzime marketingu dhe reklama	-	-
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	87,593	41,731
Udhëtime dhe dieta	624,000	222,677
Shpenzime të tjera administrative	2,991,339	1,252,724
	4,994,529	**2,567,526**

16. SHPENZIME TE TJERA

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Lëndë djegëse	1,115,625	766,921
Komisione bankare	88,167	53,952
Shërbime të tjera	412,844	424,442
Qira	1,240,246	604,200
Gjoba dhe taksa	149,000	127,953
	3,005,882	**1,977,469**

17. SHPENZIME FINANCIARE

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Fitim nga këmbime valutore	151,507	-
Të ardhura nga interesat	1,085	1,111
Shpenzime nga këmbimet valutore	(7,365)	(145,621
	145,226	**(144,510)**

18. FITIMI NETO

	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2020	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2019
Fitimi bruto	12,847,801	14,184,666
Shpenzime të panjohura	685,505	184,054
Baza e llogaritjes së tatimit	13,533,306	14,368,720
% e tatim fitimit	15%	15%

Tatim fitimi	2,029,996	2,155,308
Fitimi neto	**10,817,805**	**12,029,358**

19. AKTIVET E KUSHTEZUARA

Shoqëria është e përfshirë në një cështje gjyqësore në datën 12/11/2018 ku prentendon përfitimin e të ardhurave si vijon nëse cështja gjyqësore do të fitohet nga Shoqëria:

Dëmshpërblim: 13,913,891 Lek
Shpenzime gjyqësore: 316,416 Lek

Mundësia e humbjes apo fitimit të cështjes është e barabartë dhe gjykimi i cështjes mund të përfundojë deri pas 2 (dy) viteve. Shoqëria nuk ka njohur të ardhura as për vitin financiar 2020 duke qënë se përfitimi i të ardhurave nuk është i sigurt pasi varet nga ecuria e procesit gjyqësor, rrethana dhe kushte të cilat nuk janë nën kontrollin e shoqërisë.
Gjithashtu gjatë vitit 2019 shoqëria është e përfshirë në një cështje tjetër gjyqësore ku mundësia e humbjes apo fitimit të cështjes është e barabartë dhe gjykimi i cështjes mund të përfundojë deri pas 2 (dy)- 3 (tre) viteve. Shoqëria nuk ka njohur të ardhura për vitin financiar 2020 duke qënë se shuma nuk eshte e matshme per arsye se ne objektin e padise nuk eshte kerkuar nje gje e tille.

20. NGJARJE TE TJERA PAS DATES BILANCIT

Nuk ka asnjë ngjarje të rëndësishme pas mbylljes së vitit ushtrimor që të kërkojë korrigjime apo përshkrime në këto pasqyra financiare përveç atyre të paraqitura në shënimet e këtyre pasqyrave financiare.

CLEAN FAST Sh.p.k. NUIS: L67150701S TIRANË - ALBANIA